

URDHËR
Nr. 294, datë 15.5.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 611, DATË 1.12.2015, TË MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDASHME, “PËR
PROCEDURËN DHE RREGULLAT PËR DËRGIMIN E RASTIT, NGA AUTORITETI
PËRGJEGJËS PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN,
TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR
AZILIN DHE REFUGJATËT”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë

URDHËROJ:

1. Pika 6 e urdhrin nr. 611, datë 1.12.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, i dërgohet një kopje e formularit të gjurmëve daktiloskopike dhe atij të përzgjedhjes, së bashku me një informacion për rastin, brenda 48 orësh nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, në postën elektronike zyrtare të këtij Autoriteti”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDASHËM
Fatmir Xhafaj